



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRI E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

**SHPLLJE VENDI VAKANT PËR POZICIONIN:
DREJTOR I DREJTORISË
DREJTORIA E INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

1. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS:

Emërtesa e pozicionit: Drejtor i Drejtorisë

Klasa e pagës: II-1

Raporton te: Drejtori Ekzekutiv

2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT: Drejtori i Drejtorisë së Investimeve Strategjike(IS), përgjigjet tek Drejtori Ekzekutiv për zhvillimin dhe zbatimin e investimeve strategjike në vend dhe është përgjegjës për formulimin dhe zbatimin e strategjive të investimeve në përputhje me qëllimet dhe objektivat e agjencisë. Luan një rol vendimtar në nxitjen e suksesit të investimeve strategjike, arritjen e objektivave financiare dhe dhënien e vlerës për palët e interesuara.

3. DETYRAT KRYESORE:

- Formulimi dhe zbatimi i investimeve strategjike në përputhje me misionin, vizionin dhe qëllimet afatgjata të agjencisë.
- Mbikëqyrja e portofolit të investimeve strategjike të propozuara, duke përfshirë alokimin e aseteve, përzgjedhjen e investimeve dhe menaxhimin e rrezikut.
- Monitorimi i performancës së portofolit, vlerësimi i ekspozimit ndaj rrezikut dhe bërja e rregullimeve sipas nevojës për të optimizuar kthimet.
- Identifikimi dhe vlerësimi i mundësive të mundshme investimi, duke përfshirë kapitalin privat, kapitalin sipërmarrës, pasuritë e paluajtshme dhe klasa të tjera të aseteve.
- Kryerja e kujdesit të duhur, analizave financiare dhe vlerësimeve të rrezikut për të vlerësuar qëndrueshmërinë dhe kthimet e mundshme të mundësive të investimit.
- Negocimi i kushteve, çmimeve dhe strukturave të marrëveshjeve me partnerët e investimeve, sipërmarrësit dhe palët e tjera të interesuara.
- Bashkëpunimi me ekipet ligjore dhe financiare për të siguruar që marrëveshjet e investimeve janë të strukturuar në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me objektivat strategjike të vendit.
- Komunikimi i strategjive afatmesme dhe afatgjata të investimeve, vendimeve dhe përditësimeve të performancës me drejtuesit e lartë, anëtarët e bordit, investitorët dhe palët e tjera të interesuara.
- Ofrimi i raporteve, prezantimeve dhe përditësimeve të rregullta mbi aktivitetet e investimeve dhe performancën e portofolit.
- Identifikimi i rreziqeve të mundshme, monitorimi i ekspozimit ndaj rrezikut dhe zbatimi i masave për zbutjen e rrezikut për të mbrojtur interesat e investimit.

- Sigurimi i përputhshmërisë me ligjet përkatëse, rregulloret dhe standardet e industrisë që rregullojnë aktivitetet e investimit.
- Respektimi i standardeve etike, kërkesave të transparencës dhe përgjegjësisë të besueshmërisë në të gjitha vendimet dhe aktivitetet për investime
- Ndërtimi dhe mbajtja e marrëdhënieve me partnerët e investimeve, institucionet financiare, sipërmarrësit dhe palët e tjera të interesuara.
- Kultivimi i një rrjeti kontaktesh për të siguruar mundësi investimi, për të shfrytëzuar ekspertizën dhe për të nxitur bashkëpunimin.
- Ndërtimi dhe udhëheqja e një ekipi investimi me performancë të lartë, duke përfshirë punësimin, trajnimin dhe mentorimin e stafit.
- Vlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i proceseve, metodologjive dhe strategjive të investimit për të përmirësuar performancën e investimit, për të optimizuar kthimet e rregulluara sipas rrezikut dhe për t'iu përshtatur kushteve të ndryshimit të tregut.

4. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f.- Ndaj tij të mos jetë marrë asnjë masë disiplinore gjatë 6 muajve të fundit të periudhës kohore të punës.

5. KËRKESAT E POSAÇME:

Arsimi: Master shkencor në shkenca juridike si dhe diploma ose çertifikata të avancuara në lidhje me fushën e përgjegjësisë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvoja: Të ketë të paktën 10 vite eksperiencë pune në fushën e kërkuar.

Tjetër: Dije të përgjithshme të parimeve, koncepteve, metodave dhe teknikave të profesionit, të mjaftueshme për të realizuar detyrat e pozicionit. Aftësi për të përzgjedhur informacionin e nevojshëm ose materiale referuese të nevojshme, për të realizuar detyra që lidhen me fushën përkatëse të njohurive; aftësi shumë të mira organizative.

6. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar;
- b - Fotokopje të diplomës. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**.

Kandidatët e interesuar paraqesin kërkesën për aplikim, dokumentacionin si më sipër dhe dokumentacionin vërtetues për kriteret e përgjithshme dhe të posaçme brenda datës: **(18.12.2025 afati i fundit i aplikimit)**.

7. REZULTATET PËR FAZËN E KONKURRIMIT

Në vijim, AIDA do të realizojë:

1- Fazën e parë të konkurrimit e cila konsiston në verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore;

a- nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim.

b- nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;

2 - Faza e dytë e konkurrimit është faza e intervistimit të punonjësve të kualifikuar nga komisioni. Në këtë fazë komisioni bën një vlerësim të formimit të përgjithshëm të kandidatëve si dhe vizionit të tyre personal në lidhje me veprimtarinë e AIDA-s.

8. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Në përfundim të fazës së dytë komisioni i përzgjedhjes bën një vlerësim me pikë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë.

Për vlerësimin e kandidatëve, secili anëtar jep pikët e tij. Në përfundim pikët e grumbulluara mbledhen. Shuma e pikëve të mbledhura nga të gjithë anëtarët pjesëtohet me numrin e anëtarëve të tij dhe kjo vlerë përbën rezultatin përfundimtar.

Komisioni i Përzgjedhjes jep vlerësimin e tij sipas rregullores mbi kandidatët potencialë për punësim duke e shoqëruar me një raport përmbledhës.

Raporti përmbledhës së bashku me listën e 3(tre) kandidatëve që kanë arritur rezultate më të larta i paraqitet Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati 5 (pesë) ditor nga përfundimi i vlerësimit.